

Liga mbarëkombëtare e pingpongut

Prospekti



1. AUTORITETI

Liga kombëtare e pingpongut organizohet nga Federata e Ping Pongut të Kosovës (FPPK) dhe "Federata Shqiptare e Ping Pongut" SH. "FSHPP".

2. DATA DHE VENDI

Liga mbarëkombëtare e pingpongut do të mbahet në dy faza. Faza e parë me 11-12 dhjetor në Ferizaj do të zhvillohen 4 xhiro, ndërsa faza e dytë në fund të pranverës në Shqipëri (data dhe vendi i saktë do të caktohen më vonë).

3. LLOJI I GARAVE

Liga kombëtare e pingpongut është garë ekipore e përbërë prej katër ekipeve më të mira nga Kosova dhe katër ekipet më të mira nga Shqipëria të shpallura në vitin aktual kalendarik 2021 në konkurrencën e seniorëve meshkuj dhe femra.

Garat do të zhvillohen vetëm ndërmjet klubeve nga Kosova dhe Shqipëria, ndërsa rezultatet e ligës vendore do të merren për ndeshjet e ndërmjetme të klubeve në Kosovë dhe Shqipëri.

4. ORARI DHE SHORTI

Orari - Liga Kombëtare

Ora	Tavolina 1	Tavolina 2	Tavolina 3	Tavolina 4	Tavolina 5	Tavolina 6	Tavolina 7	Tavolina 8
	11/12/2021 - Ferizaj							
14:30	Ceremonia e hapjes							
15:00	M Xhiro 1	M Xhiro 1	M Xhiro 1	M Xhiro 1	F Xhiro 1	F Xhiro 1	F Xhiro 1	F Xhiro 1
17:00	M Xhiro 2	M Xhiro 2	M Xhiro 2	M Xhiro 2	F Xhiro 2	F Xhiro 2	F Xhiro 2	F Xhiro 2
19:00	Darka e përbashkët							
	11/12/2021 - Ferizaj							
10:00	M Xhiro 3	M Xhiro 3	M Xhiro 3	M Xhiro 3	F Xhiro 3	F Xhiro 3	F Xhiro 3	F Xhiro 3
12:00	M Xhiro 4	M Xhiro 4	M Xhiro 4	M Xhiro 4	F Xhiro 4	F Xhiro 4	F Xhiro 4	F Xhiro 4
14:00	Dreka e përbashkët							

5. RREGULLAT

Të gjitha duelet do të zhvillohen sipas rregullave të ITTF. Gjyqtari kryesor është autoriteti i vetëm i ndarjes së drejtësisë në bazë të fakteve që ndodhin në arenën e garave.

Në rast të apelit ndaj ndonjë vendimi që merr gjyqtari, përfaqësuesi i klubit duhet ti drejtohet tavolinës zyrtare, respektivisht Arbitrit.

Të gjitha ndeshjet do të kenë nga një gjyqtarë. Shpenzimet e gjyqtarëve do të mbulohen nga federata mikpritëse sipas buxhetit të paraparë të federatës.

6. PAISJET

Garat zhvillohet në 8-të tavolina. Tavolinat janë Stag, dhe do të luhet me topa Stag 40+ ITTF approved. Ekipet duhet të mbajnë fanela të njejta gjatë garës ekipore dhe me ngjyrë të ndryshme nga kundërshtari.

7. ARBITRI DHE GJYQTARET

Drejtësia në këto gara ekipore do të bëhet nga katër gjyqtarët më të mirë nga Kosova dhe katër gjyqtarët më të mirë nga Shqipëria, nëse federata mysafire nuk mund të sjell të gjithë gjyqtarët obligohet federata vendase që të sjellë gjyqtarët tjerë.

Gjyqtarët duhet të kenë uniformë formale për gara të pingpongut.

8. REZULTATET DHE TITULLI I FITUAR

Shpallja e kampionit të Ligës Kombëtare në pingpong në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave do të bëhet pasi të kryhen të dy fazat, respektivisht në fund të pranverës në Shqipëri, dhe kampioni shpallet për vitin 2021/2022, me që rast merr edhe shpërblimin e paraparë nga të dy federatat.

Rezultatet e garave ekipore të ekipeve vendase do të merren dhe konsiderohen ato të zhvilluara në kampionatet shtetërore të fundit dhe ndeshjet në këtë ligë do bëhen vetëm ndërmjet ekipeve të Kosovës dhe Shqipërisë.

9. SIGURIA DHE NDIHMA MJEKËSORE

Organizatori do të ofrojë sigurinë fizike për të gjithë pjesëmarrësit zyrtar të kësaj lige si dhe do të organizoj dhe ofroj ndihmën mjekësore në rast të nevojës dhe lëndimeve aksidentale gjatë garave.

Të gjithë lojtarët duhet të kenë dëshminë e vaksinës ose testit PCR kur të udhëtojnë.